



Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 të OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

PARTNERITETE PËR BARAZINË
GJINORE NË PRONËSINË DHE
KONTROLLIN E TOKËS

2020

5.a.2
INDIKATORI

ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

TË TRANSFORMOJMË BOTËN TONË: PROGRAMI 2030 I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM PËRFSHIN 17 OBJEKTIVA PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM DHE 169 QËLLIME

Më 25 shtator 2015, në Samitin e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Nju Jork, 193 Shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara miratuan qëllime të reja globale për 15 vitet e ardhshme.

Programi 2030 është bërë pika kryesore e referimit për politikën dhe programet e zhvillimit në nivel vendi.



KUSH PËRGJIGJET PËR GJURMIMIN E INDIKATORËVE TË OZHQ-VE?

Agjencitë kujdestare përgjigjen për drejtimin e punës për bashkërendimin dhe drejtimin e procesit të monitorimit dhe raportimit në emër të partnerëve të tjerë dhe palëve të interesuara. *Metadata:* Komisioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara (KB) ka publikuar metadatën e marra/përgatitura nga agjencisë kujdestare për të gjitha 17 objektivat.

Për metadatën e lidhura me treguesit e tokës, vizitoni:

[OZHQ 5.a.1](#)

[OZHQ 5.a.2](#)

[OZHQ 1.4.2](#)

ORGANIZATA E USHQIMIT DHE BUJQËSISË (FAO) ËSHTË AGJENCIA KUJDESTARE PËR 21 INDIKATORËT





PARTNERITETE PËR BARAZINË GJINORE NË PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS



QËLLIMI 5.a

Ndërmarrja e reformave për t'u dhënë grave të drejta dhe mundësi të barabarta ndaj burimeve ekonomike, trashëgimisë, si edhe ndaj pronësisë dhe kontrollit të tokës dhe ndaj formave të tjera të pronave, shërbimeve financiare dhe burimeve natyrore, në përputhje me ligjet kombëtare.

Qëllimi 5.a matet përkundrejt dy indikatorëve: treguesit sasiorë dhe treguesit cilësor të cilët, të matur bashkë, bëjnë të mundur që vendet të monitorojnë ndikimin e reformës ligjore në pronësinë dhe/ose kontrollin e tokës nga gratë.

INDIKATORI 5.a.1

Indikatorit 5. a.1: “(a) Përqindja e njerëzve me pronësi apo të drejta të sigurta ndaj tokës bujqësore (nga gjithë popullsia bujqësore), sipas seksit; dhe (b) Përqindjes së grave midis pronarëve apo mbajtësve të të drejtave të tokës bujqësore”, sipas llojit të së drejtës ndaj tokës.

INDIKATORI 5.a.2

Përqindja e vendeve ku kuadri ligjor (duke përfshirë të drejtën zakonore) garanton të drejta të barabarta të grave lidhur me pronësinë dhe/ose kontrollin e tokës.

FAO është agjencia kujdestare për këtë tregues dhe ka përgatitur një metodologji raportimi në partneritet me agjencitë dhe partnerët kontribues.

PËRSE DUHET NJË INDIKATOR LIGJOR PËR BARAZINË GJINORE NË LIDHJE ME PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS?


Përfshirja e indikatorit 5.a.2 pranon se një barazi më e madhe në pronësinë dhe kontrollin e tokës kontribuon në efikasitetin ekonomik dhe ka efekte pozitive të shumëfishta edhe për OZHQ-të e tjera, duke përfshirë uljen e varfërisë (Qëllimi 1), siguria ushqimore (Qëllimi 2) dhe mirëqenien e familjeve, komuniteteve dhe vendeve (Objektivat 3, 11 dhe 16, ndër të tjera).

ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ


ÇFARË MJETESH KEMI NË LIDHJE ME TË DREJTËN E BARABARTË GJINORE NDAJ TOKËS?



Programi 2030 për zhvillim të qëndrueshëm




FAO dhe treguesit e OZHQ-ve. Krahasimi me Programin 2030 të Zhvillimit të Qëndrueshëm




Udhëzuesi për raportimin mbi indikatorin 5.a.2 të OZHQ-ve



Mjeti ligjor i vlerësimit



Udhëzime jo detyruese për administrimin e të drejtës ndaj tokës, peshkimit dhe pylltarisë në kuadrin e sigurisë ushqimore kombëtare



Administrimi i tokës nga gratë dhe burrat

Udhëzuesi teknik për të mbështetur arritjen e administrimit të përgjegjshëm të barabartë gjinor të së drejtës ndaj tokës



Krijimi i një sistemi për regjistrimin e të drejtave ndaj tokës dhe regjistrimin e parë



Administrimi i përgjegjshëm i të drejtës ndaj tokës dhe ligji


Udhëzuesi për avokatët dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve ligjore



Përmirësimi i mënyrave për të regjistruar të drejtat ndaj tokës



Baza e të dhënave të FAO-s për gjininë dhe të drejtat ndaj tokës



Udhëzime rajonale për forcimin e zbatimit të barazisë gjinore në praktikat noteriale dhe për regjistrimin në Evropën Juglindore

Udhëzimet rajonale për forcimin e barazisë gjinore në praktikat noteriale ofrojnë hapa të shpejta dhe të lehta dhe lista me detyra për të ndihmuar noterët të ushtrojnë kujdesin e duhur në shërbimet që ata ofrojnë sipas ligjit, duke identifikuar dhe mbrojtur të drejtat e të gjitha grave dhe bijave me interes të ligjshëm në këtë shërbim. Gjithashtu, ato japin informacion shtesë për ata noterë që duan të shtojnë njohuritë e tyre dhe të kuptojnë më mirë pasojat gjinore në shërbimet që ofrojnë, si dhe sugjerime për mënyrën se si ata të angazhohen në avokati.

SË SHPEJTI

- Udhëzime rajonale për forcimin e barazisë gjinore për zyrat e regjistrimit në Evropën Juglindore
- Trajnime kombëtare për zbatimin e Udhëzimeve Rajonale për forcimin e barazisë gjinore në praktikat noteriale dhe të regjistrimit në Evropën Juglindore



PARTNERITETE PËR BARAZINË GJINORE NË PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS

INDIKATORI 5.A.2 I OZHQ-ve PROCESI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIMIT

PROCESI I RAPORTIMIT



Ekspertët ligjorë të institucioneve përkatëse kombëtare analizojnë të gjithë dispozitat ligjore ekzistuese për të përcaktuar nëse ekzistojnë në to gjashtë treguesit e tërthortë të konsideruar praktika të mira ndërkombëtare për garantimin e të drejtave gjinore të pronësisë dhe kontrollit të tokës.

GJASHTË TREGUESIT E TËRTHORTË MBULOJNË:

TREGUESI I TËRTHORTË A

Regjistrimi i përbashkët i tokës është i detyrueshëm dhe inkurajohet përmes stimujve ekonomike për çiftet e martuara dhe/ose të pamartuara.

TREGUESI I TËRTHORTË C

Të drejta të barabarta trashëgimie për gratë dhe vajzat.

TREGUESI I TËRTHORTË E

Mbrojta e të drejtave të grave ndaj tokës kur ligji e ka njohur shprehimisht të drejtën zakonore.

TREGUESI I TËRTHORTË B

Pëlqimi bashkëshortor për transaksione me tokën.

TREGUESI I TËRTHORTË D

Caktimi i burimeve financiare për rritjen e pronësisë dhe kontrollit të tokës nga gratë.

TREGUESI I TËRTHORTË F

Kuota të detyrueshme për pjesëmarrjen e grave në institucionet e menaxhimit dhe administrimit të tokës.

FAO, si agjencia kujdestare llogarit rezultatet dhe përqindjen e vendeve ku po bëhet përparim në kuadrin ligjor (përfshirë të drejtën zakonore) që garanton të drejta të barabarta të grave për pronësinë dhe / ose kontrollin e tokës. Metodologjia u miratua nga agjencia ndërsektoriale dhe Grupi i Ekspertëve për Indikatorët e OZHQ-ve (IAEG-SDGs) në nëntor 2017 dhe treguesi u azhurnua në Nivelin II (TIER 2).

ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ



INICIATIVA RAJONALE E BALLKANIT PERËNDIMOR

Iniciativa rajonale e Ballkanit Perëndimor trajton sfidat me të cilat përballen gratë në qasjen e tyre ndaj pronësisë dhe kontrollit të tokës. Në Ballkanin Perëndimor, janë ngritur ekipe shumëpalëshe gjinore që përbëhen nga specialistë të administrimit të tokës, politikëbërës të qeverisë, punonjës gjinorë, OJQ vendore dhe noterë në mbështetje të procesit të forcimit të barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale në të drejtat e pronës.

Në 2013, të dhënat e ndara sipas seksit të prodhuara nga secili vend tregonin nivele të ulëta të pronësisë së grave mbi tokën. Qeveritë e rajonit u habitën kur mësuan se pronësia e tokës nga femrat në disa vende ishte vetëm 3 për qind, dhe jo më shumë se 30 për qind në të shumtën e rasteve. Përdorimi i të dhënave ekzistuese për regjistrimin treguan se një informacion i tillë mund të ishte i rëndësishëm për informimin e dialogut me politikë bërësit lidhur me barazinë gjinore në të drejtat e pronës.

PARTNERITET DHE REZULTATET

Që nga viti 2015 dhe miratimi i Programit 2030, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), GmbH në emër të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), FAO, dhe Unioni Ndërkombëtar i Noterëve (UINL) i kanë përqendruar përpjekjet e tyre në dy objektiva kryesore:

- 1 lehtësimi i raportimit dhe monitorimit të vendeve sipas indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve për barazinë gjinore në pronësinë dhe kontrollin e tokës;**
- 2 kontributi për zbatimin e indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve në bashkëpunim me përfaqësuesit lokalë të ndryshimit.**

Për Objektivin 1, rezultatet e vlerësimeve ligjore të kryera gjatë viteve 2015-2016 janë përditësuar në fillim të 2020 për të mbështetur raundin tjetër të raportimit për OZHQ-të. Këto vlerësime janë kryer duke përdorur Instrumentin ligjor të vlerësimit të FAO-s (LAT) për të drejtën e barabartë gjinore ndaj tokës, i cili është projektuar posaçërisht për të zbatuar Udhëzimet Vullnetare për Rregullimin e Përgjegjshëm të së Drejtës ndaj Tokës, Peshkimit dhe Pyjeve në kontekstin e sigurisë kombëtare ushqimore (VGGT) parimit të barazisë gjinore dhe për të lehtësuar raportimin e vendeve sipas indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve. VGGT-të u miratuan në vitin 2012 nga Komiteti për Sigurinë Ushqimore Botërore (CFS), duke i dhënë legjitimitet dhe autoritet rekomandimeve të politikave të saj. Zbatimi i LAT-it ka ndihmuar për të identifikuar disa nga pengesat ligjore dhe teknike të qasjes së grave në pronësinë e tokës dhe ka nxjerrë në dritë disa probleme lidhur me zbatimin e saj.

Për Objektivin 2, FAO dhe GIZ janë lidhur me UINL-në për të identifikuar nevojat për rritjen e kapaciteteve të noterëve dhe zyrave të regjistrimit në rajon dhe për të ndihmuar në plotësimin e boshllëkut në zbatim, të gjetur sipas Objektivit 1. U organizua një seminar, i cili mbledhi përfaqësues të ministrive të drejtësisë të rajonit, noterë dhe përfaqësues të zyrave të regjistrimit. Ky forum u dha mundësi profesionistëve të vendeve të shkëmbejnë përvojat, sfidat dhe zgjidhjet dhe ndihmoi që partnerët e zhvillimit të ofrojnë mbështetje të integruar dhe objektive të rrënjësor në realitetet lokale dhe me qëllim zbatimin e VGGT-ve dhe të indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve. Ky bashkëpunim ka çuar në publikimin e “Udhëzimeve për forcimin e barazisë gjinore në praktikën noteriale në Evropën Juglindore”. FAO, GIZ dhe UINL tani janë duke mbështetur përshtatjen nga vendet e rajonit të këtyre udhëzimeve për të qenë në harmoni me kornizat ligjore kombëtare dhe veçoritë e secilit vend.



PARTNERITETE PËR BARAZINË GJINORE NË PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS

**MJETI LIGJOR
I VLERËSIMIT
(LAT) PËRFSHIN
GJASHTË TREGUES
TË TËRTHORTË
TË OZHQ-ve
DHE INKURAJON
VENDET TË
PËRCAKTOJNË
PËRPARËSITË
E REFORMAVE
LIGJORE TË
NEVOJSHME PËR
ARRITJEN**

ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

NË NIVEL VENDI

Indikatorit 5.a.2 mbështetet në Mjetin Ligjor të Vlerësimit të FAO-s (LAT) për të drejta të barabarta gjinore ndaj të drejtës së tokës. LAT përfshin vlerësimin e shkallës në të cilën korniza e politikave dhe e ligjeve të një vendi mbështet masat për të drejtën ndaj tokës, duke e testuar atë kornizë përkundrejt 26 indikatorëve të pranuar me konsensus ndërkombëtar, në veçanti, përkundrejt Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), dhe praktikave të pranuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë VGGT-në.

LAT-i përfshin gjashtë tregues të tërthortë të OZHQ-ve dhe u lejon vendeve të përcaktojnë përparësitë dhe zbatojnë reformat ligjore të nevojshme për arritjen e barazisë ligjore si me ligj, ashtu edhe në praktikë. Ndonëse procesi i raportimit nuk është një kërkesë e indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve, vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë zbatuar LAT-in si një hap të parë drejt raportimit të OZHQ-ve, për të parë përparimin e bërë drejt barazisë gjinore në pronësinë dhe kontrollin e tokës dhe përcaktuar fushat ku nevojiten të ndërmerren reforma të mëtejshme.

NIVELI TRAJONAL

Në nivel rajonal, vendet kanë shkëmbyer rezultatet e indikatorit 5.a.2 të vlerësimit të OZHQ-ve dhe LAT-in përmes takimeve rajonale dhe publikimeve të përbashkëta. Kjo ka ndihmuar për dhënien dhe vazhdimin e mbështetjes për reformën ligjore dhe administrative dhe për përpjekje të tjera që duhet të ndërmerren nga secili vend.

Vlerësimi i indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve dhe LAT-i i ndihmojnë vendet të identifikojnë ngjashmëritë dhe shkëmbejnë praktikatat më të mira, si edhe të mësojnë nga përvojat e njëri tjetrit.



ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

NË MBËSHTETJE TË PROGRAMIT 2030

Indikatorit 5.a.2 I OZHQ-ve FAO, Zhvillimi dhe Bashkëpunimi Gjerman, UINL, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Grupi i Bankës Botërore dhe partnerë të tjerë të zhvillimit janë duke mbështetur rajonin e Ballkanit Perëndimor për forcimin e barazisë gjinore në pronësinë dhe kontrollin e tokës dhe duke kontribuar në zbatimin dhe raportimin e indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve.

HISTORI TË TREGUARA NGA NOTERË

Noterët në rajon kanë identifikuar raste kur gratë kanë humbur pronësinë e tokës për shkak ose të mungesës së procedurave të standardizuara nga organet legjislative, apo për shkak të ekzistencës së zakoneve diskriminuese. Në një numër të madh rastesh, gratë kanë hequr dorë nga të drejtat e tyre të pronësisë për shkak të presionit shoqëror dhe në disa raste, për shkak të besimit se ato nuk kanë qenë pronare të tokës së tyre.

PRITSHMËRITË PËR TË ARDHMEN

Në kuadër të Bashkëpunimit gjerman për Zhvillim, Fondi i Hapur Rajonal – Reforma ligjore e GIZ-it vijon të mbështetë ministritë e drejtësisë, dhomat e noterëve dhe zyrat e regjistrimit në Evropën Juglindore për të zbatuar kornizat ligjore për fuqizimin ekonomik të grave, për t'u mundësuar noterëve të marrin në konsideratë të drejtat e grave në transaksionet ndërkufitare dhe për të zbatuar barazinë gjinore në punën e përditshme të noterëve dhe të zyrave të regjistrimit përmes ndihmës teknike, shkëmbimeve rajonale, rritjes së kapaciteteve dhe ndërjegjësimit.



Seminar i mbajtur për Ballkanin Perëndimor për përmirësimin e barazisë gjinore në drejtim të pronësisë dhe kontrollit të tokës, 14 shtator 2018, Rome, Itali.

UINL është e angazhuar për të luajtur një rol kritik në arritjen e indikatorit 5.a.2. Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit nënshkruar nga FAO dhe UINL në 8 janar 2016, UINL po jep mbështetje teknike për përshtatjen nga vendet të udhëzimeve rajonale për forcimin e barazisë gjinore në praktikat noteriale. Gjithashtu UINL po përgatit një Udhëzues të ri teknik VGGT-të mbi rolin e noterëve në mbështetje të zbatimit të Udhëzimeve Vullnetare për Rregullimin e Përgjegjshëm të së Drejtës së Tokës.

Ekipi shumë-disiplinor i FAO-s është i angazhuar në mbështetjen e vendeve për të vlerësuar progresin e bërë sipas indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve, duke përfshirë përmes mbështetjes së bashkëpunimit ndër-rajonal dhe shkëmbimit të njohurive midis rajoneve të ndryshme.



Prezantimi i projektit të GIZ-it "Forcimi i fuqisë ekonomike të grave", nëntor 2019, Tiranë, Shqipëri.



PARTNERITETE PËR BARAZINË GJINORE NË PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS

REZULTATET E TREGUESVE LAT/TREGUESVE TË TËRTHORTË TË OZHQ-VE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në janar 2020 LAT-i u krye përsëri, në përputhje me metodologjinë zyrtare të përdorur për raportimin mbi OZHQ-të sipas indikatorit 5.a.2.

TREGUESI I LAT-IT		SHQIPËRIA	BIH	SERBIA	MAQEDONIA E VERIUT	MALI I ZI	KO-SOVA*	METODOLOGJIA E LAT-IT
18(a)	Regjistrimi i përbashkët i tokës është i detyruar apo inkurajohet për çiftet e martuara	3	0	2	2	2	3	0 Mungesa e përfaqësuesit ligjor
18(b)	Regjistrimi i përbashkët i tokës është i detyruar apo inkurajohet për çiftet e martuara	0	0	2	2	2	2	0.5 Po përgatitet një politikë që përfshin treguesin e tërthortë
17(a)	Pëlqimi bashkëshortor kërkohet për transaksione toke	2	0	2	2	2	3	1.5 Ekziston një politikë që përfshin treguesin e tërthortë
17(b)	Pëlqimi i partnerëve kërkohet për transaksione toke	0	0	2	2	2	3	1 Ekziston një politikë që përfshin treguesin e tërthortë
20(a)	E drejtë e barabartë e bashkëshortëve të mbijetuar mashkull dhe femër, apo partnerëve ndaj një përqindje të pasurisë së të vdekurit	2	2	2	2	2	2	1.5 Projekt legjislativ (ligj apo tjetër) përmban indikatorin
21(a)	E drejtë e barabartë e mashkullit dhe femrës që mbetet gjallë për përdorim gjatë gjithë jetës së shtëpisë së familjes	0	0	0	0	0	2	2 Treguesi i tërthortë del në ligjin kryesor
22(a)	E drejtë e barabartë trashëgimie për bijtë dhe bijat	2	2	2	2	2	2	3 Treguesi i tërthortë del në legjislativionin dytësor
22(b)	E drejta e bijve dhe bijave për të trashëguar pjesë të barabarta	2	2	2	2	2	2	NP Treguesi i tërthortë Inuk përdoret
9	Burimet financiare jepen për të shtuar pronësinë dhe kontrollin e tokës nga gratë	1	1	0	0	0	0	
10	Janë vendosur kuota për pjesëmarrjen e grave në menaxhimin e tokës dhe institucionet e administratës	2	2	2	0	0	0	

* Referenca ndaj Kosovës duhet të kuptohet në kontekstin e rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999)

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE NGA PYETËSORI I RAPORTIMIT PËR INDIKATORIN 5.A.2 TË OZHQ-VE (2020)

TREGUES I TËRTHORTË A	Regjistrimi i përbashkët	I pranishëm
TREGUES I TËRTHORTË B	Pëlqimi bashkëshortor	I pranishëm
TREGUES I TËRTHORTË C	Trashëgimia	I pranishëm
TREGUES I TËRTHORTË D	Caktimi i fondeve	Jo i pranishëm
TREGUES I TËRTHORTË E	Sistemet zakonore të të drejtave të tokës	Nuk përdoret
TREGUES I TËRTHORTË F	Kuotat	I pranishëm

Nivele të larta të garancive për barazi gjinore në pronësinë dhe/ose kontrollin e tokës në kornizën ligjore.

Numri i përgjithshëm i treguesve të tërthortë të pranishëm në kornizën ligjore:

asnjë një dy tre katër pesë gjashtë

ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Përcaktimi i progresit të bërë që nga vlerësimi i fundit dhe raportimi mbi OZHQ-të dhe përgatitja e raundit tjetër të raportimit mbi OZHQ-të.

Futja e lidhjes digjitale të regjistrave për lehtësimin e punës dhe bashkërendimin midis noterëve dhe zyrave të regjistrimit.

Ndryshimi i legjislacionit për të siguruar të drejtën e bashkëshortëve të mbetur gjallë për përdorimin gjatë gjithë jetës së shtëpisë së familjes.

Në vendet ku ligji garanton të drejtat dhe detyrimet e pronësisë të partnerëve bashkëjetues, të lehtësohet identifikimi dhe regjistrimi i këtyre të drejtave.

Të mbështetet matja dhe zbatimi i indikatorit 5.a.1 të OZHQ-ve për të siguruar që kadastrat e pronave të patundshme të mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë për pronarët e tokës dhe për mbajtësit e tjerë të të drejtave mbi tokën.

Dhomat kombëtare të Noterëve duhet të miratojnë zyrtarisht udhëzimet që përmbajnë shtojcat kombëtare të “Udhëzimeve rajonale për forcimin e barazisë gjinore në praktikat noteriale” për të sqaruar detyrimet e noterëve në lidhje me barazinë gjinore dhe harmonizuar praktikat në të gjitha zyrat noteriale.





PARTNERITETE PËR BARAZINË GJINORE NË PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS

PRAKTIKA TË MIRA NGA BALLKANI PERËNDIMOR

- **Të dhëna të ndara sipas gjinisë gjenerohen nga regjistrat e pronave dhe sistemet e Teknologjisë së Informacionit të kadastrave në Ballkanin Perëndimor.**
- **Pëlqimi bashkëshortor është i detyrueshëm za për çdo transaksion që përfshin prona martesore-bashkëshortët administrojnë dhe disponojnë pronën martesore bashkërisht dhe me konsensus në Shqipëri, Serbi, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Kosovë*.**
- **Regjimi automatik pronësor për prona të përftuara gjatë një bashkimi konsensual të lidhur ligjërisht (bashkëjetesë) është bashkë bashkëpronësi apo pronësi e përbashkët në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë*.**
- **Regjistrimi i përbashkët i tokës në pronësi të përbashkët të çifteve të martuara është i detyrueshëm apo inkurajohet nëpërmjet stimujve ekonomikë në Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.**
- **Procedura e thjeshtuar e regjistrimit ex-officio për të dy bashkëshortët (pronësi e përbashkët), bazuar në certifikatën martesore dhe në deklaratën e dy bashkëshortëve për regjistrimin e mëvonshëm të bashkëshortit të paregjistruar në rastin e pronave të përftuara gjatë martesës në Serbi që nga 8 qershori 2018.**
- **Në Serbi është ulur tarifa e regjistrimit të pronës nëpërmjet një stimuli tatimor që është një shumë simbolike, vetëm 3 euro, me qëllim për të stimuluar dhe rritur pronësinë dhe kontrollin e grave ndaj tokës në rastet kur të dy bashkëshortët/partnerët janë të regjistruar si bashkëpronarë të pronës dhe për regjistrimin e pronave të njerëzve me paaftësi (Ligji serb për tatimet e Administratës Publike).**
- **Autoriteti i caktuar për të kryesuar raportimin për treguesin 5.a.2. të OZHQ-ve në Maqedoninë e Veriut, Serbi.**
- **Qendra të lëvizshme të shërbimit të regjistrimit janë hapur në Serbi, në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe në Republikën Srpska.**
- **Në Shqipëri, Ligji 111/2018 “Për kadastrat” e bën të detyrueshëm regjistrimin e pasurive martesore. Pas tij u miratua Urdhri nr. 1150, datë 3 qershor 2019 i cili përcakton procedurën për korrigjimin e dosjeve me të dhëna për pronave të patundshme kur pjesa përkatëse e pronësisë midis bashkëshortëve është regjistruar vetëm në emrin e njërit bashkëshort.**
- **Noterët dhe Agjencitë për Kadastrat e Pronave të Patundshme po organizojnë ditë të hapura për ofrimin e ndihmës ligjore pa pagesë dhe ndihmë profesionale për qytetarët e Maqedonisë së Veriut.**
- **Regjistrat civilë dhe Regjistrat e pronave ndërveprojnë me njëri tjetrin, duke i lehtësuar procedurat e trashëgimisë dhe transferimin e pronësisë në Serbi, Shqipëri dhe Kosovë*. Kjo është planifikuar të bëhet edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë.**
- **Projekti ka rritur ndërgjegjësimin lidhur me përfitimet e regjistrimit të të dy bashkëshortëve në të gjithë Ballkanin Perëndimor.**
- **Rregulli për ndryshimet në Rregulloren për përcaktimin e shpërblimeve dhe tarifave për noterët në Bosnjë dhe Hercegovinë, Republika Srpska, përcakton një zbritje të tarifës së noterit kur bashkëshortët përftojnë apo transferojnë një pronë martesore.**
- **Kosova* ka miratuar Udhëzimin administrativ (QRK) nr. 02/2020 për regjistrimin e pronave të përbashkëta të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë. Regjistrimi i përbashkët inkurajohet nëpërmjet stimujve ekonomikë në Kosovë*, duke qenë se Agjencia Kadastrale nuk kërkon pagesa për regjistrimin nëse të dy bashkëshortët kërkojnë regjistrim të përbashkët.**

* Referencat ndaj Kosovës duhet të kuptohen në kuadër të rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999)



ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

NDIKIMI NË SHIFRA 2013 PËRKUNDREJT 2019

BOSNJA DHE HERCEGOVINA, FEDERATIA E BOSNIËS DHE HERCEGOVINËS, 2013

26,84 % e të dhënave për gra pronare apo bashkëpronare



- 37.81% kryeqyteti Sarajeva (më e larta)
- 20.17% komuna e Buzimit (më e ulëta)



BOSNJA DHE HERCEGOVINA, FEDERATIA E BOSNIËS DHE HERCEGOVINËS, 2019

38.33% e të dhënave për gra pronare apo bashkëpronare



- 42.84% kryeqyteti Sarajeva (më e larta)
- 20.23% komuna e Buzimit (më e ulëta)



BOSNJA DHE HERCEGOVINA, REPUBLIKA SRPSKA, 2013

29.97% e të dhënave për gra pronare apo bashkëpronare



- 33.20% Banja Luka Capital (Më e larta)
- 19.46% Bashkia e Sokolac (Më e ulëta)



BOSNJA DHE HERCEGOVINA, REPUBLIKA SRPSKA, 2019

33.83% e të dhënave për gra pronare apo bashkëpronare



- 34.58% Kryeqyteti Banja Luka (Më e larta)
- 22.23% Bashkia e Tërnovës (Më e ulëta)



KOSOVA*, 2013

17.04% e të dhënave për gra pronare apo bashkëpronare



- 17.24% kryeqyteti, Prishtina (Më e larta)
- 8% Komuna e Gillogocit (Më e ulëta)



KOSOVA*, 2019

17.86% e të dhënave për gra pronare apo bashkëpronare

- 18.47% kryeqyteti, Prishtina (Më e larta)
- 9.2% Komuna e Malishevës (Më e ulëta)



* Referencat ndaj Kosovës duhet të kuptohen në kuadër të rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999)




PARTNERITETE PËR BARAZINË GJINORE NË PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS

NDIKIMI NË SHIFRA 2013 PËRKUNDREJT 2019

MALI I ZI, 2013

25.99% e të dhënave
për gra pronare apo
bashkëpronare


- 31% Kryeqyteti,
Podgorica (Më e larta)
- 15% Bashkia
e Rozajës



MALI I ZI, 2019

32% ze të dhënave
për gra pronare apo
bashkëpronare



- 37% rajoni më jugor
(Më e larta)
- 24% rajoni më verior
(Më e ulëta)



MAQEDONIA E VERIUT, 2013

16.63% e të dhënave
për gra pronare apo
bashkëpronare



- 18% kryeqyteti,
Shkupi (Më e larta)
- 7% Bashkia e
Poloskës (Më e ulëta)



MAQEDONIA E VERIUT, 2019

27.27% e të dhënave
për gra pronare apo
bashkëpronare



- 34.01% kryeqyteti,
Shkupi (Më e larta)
- 13.96% Bashkia e
Poloskës (Më e ulëta)



SERBIA, 2013

31.73% e të dhënave
për gra pronare apo
bashkëpronare



- 35.72% - Beogradi
- 51.3% Bashkia e
Stari Gradit (Më e larta)
- 13,38% - Bashkia e Preshevës



SERBIA, 2019

35.50% e të dhënave
për gra pronare apo
bashkëpronare

- 39.47% - Beogradi
- 58.44% Bashkia e
Adës (Më e larta)
- 14,73% - Bashkia e Preshevës



ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

TË SHOHIM PËRTEJ BALLKANIT PERËNDIMOR: VLERËSIME LIGJORE NË KAUKAZIN E JUGUT

Në fillim të 2019, qeveritë e Azerbajxhanit, Armenisë dhe Gjeorgjisë shprehën interes për të bërë një analizë të kornizave ligjore të tyre përkundrejt treguesve të tërthortë të indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve. Duke u bazuar në këtë bashkëpunim të suksesshëm në Ballkanin Perëndimor, FAO dhe GIZ i zgjeruan partneritetet e tyre në Kaukazin e Jugut për të lehtësuar raportimin sipas indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve.

1. Prezantimi i LAT-it dhe metodologjisë së raportimit për OZHQ-të përpara përfaqësuesve të institucioneve kombëtare të administratës së tokave dhe zyrave statistikore, organizatave të përfshira në promovimin e barazisë gjinore dhe palëve të tjera të interesuar.

Këto seminare ishin një mundësi për të analizuar progresin e arritur dhe hapat e marra nga qeveritë kombëtare për forcimin e barazisë gjinore sipas ligjit, por edhe në praktikë. Megjithatë të tre vendet kanë miratuar strategji gjinore dhe janë angazhuar në reformën ligjore, pjesëmarrësit identifikuan një numër pengesash ekzistuese kulturore dhe administrative për arritjen e barazisë gjinore në pronësinë dhe kontrollin e tokës. Këto diskutime ofruan një bazë të shëndoshë për një analizë të thelluar të kuadrit të politikës dhe të ligjeve përkundrejt treguesve të tërthortë të indikatorit 5.a.2 të OZHQ-ve dhe për të inkurajuar diskutimet kombëtare rreth opsioneve të politikave, administrative dhe ligjore për përsheptimin e realizimit të barazisë gjinore në praktikë.

2. Në bashkëpunim me institucionet përkatëse kombëtare, identifikimi i ekspertëve ligjorë kombëtarë me përvojë në të drejtat e pronës dhe të drejtat e njeriut.

Këta ekspertë u trajnuan për mjetet e vlerësimit dhe metodologjitë për të siguruar një rishikim konsekuent të ligjeve të brendshme. Gjatë një periudhe 20 ditore, ata mblodhën të gjitha instrumentet përkatës, duke përfshirë politikat, projekt politikat, ligjet, projekt ligjet dhe i analizuan këto dokumente për të përcaktuar nëse treguesit e tërthortë janë përfshirë në kornizat ligjore, apo janë në proces të përfshirjes nëpërmjet masave për miratimin e politikave apo reformave ligjore. Rezultatet e vlerësimeve konfirmojnë se ndonëse disa garanci të barazisë ligjore në pronësinë dhe/ose kontrollin e tokës ekzistojnë në kornizën ligjore, vendet në rajon duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të arritur nivele më të larta garancish dhe të sigurojnë që në praktikë burrat dhe gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mbrojtjet e ofruara nga ligji lidhur me të drejtat e tyre të pronësisë.

3. Paraqitja e rezultateve dhe miratimi i tyre.

Rezultatet u paraqitën në fillim të 2020 në seminare kombëtare në Azerbajxhan dhe Gjeorgji. Seminari kombëtar i planifikuar në Armeni është shtyrë për shkak të shpërthimit të COVID-19.



Seminari i Azerbajxhanit



PARTNERITETE PËR BARAZINË GJINORE NË PRONËSINË DHE KONTROLLIN E TOKËS

REZULTATET E LAT-IT

LAT INDIKATOR		Armenia	Azerbajx- hani	Gjeorgia
18(a)	Regjistrimi i përbashkët i tokës është i detyrueshëm apo inkurajohet për çiftet e martuara	0	0	0
18(b)	Regjistrimi i përbashkët i tokës është i detyrueshëm apo inkurajohet për çiftet e pamartuara	0	0	0
17(a)	Pëlqimi bashkëshortor kërkohet për transaksione me tokë	2	2	0
17(b)	Pëlqimi i partnerëve kërkohet për transaksione me tokën.	0	0	0
20(a)	E drejtë e barabartë e mashkullit dhe femrës që mbetet gjallë apo partnerit për të marrë një përqindje të pasurisë së të vdekurit.	2	2	2
21(a)	E drejtë e barabartë e bashkëshortëve meshkuj dhe femra për të përdorur shtëpinë e familjes gjatë gjithë jetës së tyre.	2	0	0
22(a)	E drejtë e barabartë trashëgimie për bijtë dhe bijat	2	2	2
22(b)	E drejta e bijve dhe bijave për të trashëguar përqindje të barabarta.	2	2	2
9	Burimet financiare caktohen për të rritur pronësinë dhe kontrollin e tokës nga gratë.	0	0	0
10	Janë vendosur kuota për pjesëmarrjen e grave në institucione të menaxhimit dhe administrimit të tokës	0	0	0

LAT METODOLOGJIA

- 0 Mungesa e përfaqësuesit ligjor
- 0.5 Po përgatitet një politikë që përfshin treguesin e tërthortë
- 1.5 Ekziston një politikë që përfshin treguesin e tërthortë
- 1 Ekziston një politikë që përfshin treguesin e tërthortë
- 1.5 Projekt legjislativi (ligj apo tjetër) përmban indikatorin
- 2 Treguesi i tërthortë del në ligjin kryesor
- 3 Treguesi i tërthortë del në legjislativin dytësor
- NP Treguesi i tërthortë nuk përdoret



ARRITJA E INDIKATORIT 5.A.2 TË OZHQ-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE MË TEJ

PARTNERITETE PËR
BARAZINË GJINORE
NË PRONËSINË DHE
KONTROLLIN E TOKËS

2020